

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji në përbërje nga gjyqtarët, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nebojša Boričić anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

L. B. nga ...,

Duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/R/207/2013, të datës 11 Qershor 2013, (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA11753), në seancën e mbajtur me datë 24 Dhjetor 2020, merr;

AKTGJYKIM

Hedhet Poshtë si e pas afatshme, ankesa e parashtruar nga L. B. , kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/R/207/2013, të datës 11 Qershor 2013, për sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP, me numër KPA11753.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike;

1. Me datë 05 Tetor 2007, L. B., ka parashtruar kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP-së), në cilësinë e bartëses së të drejtës pronësore, (tutje BDP), me të cilën ka kërkuar konfirmimin e të drejtës së shfrytëzimit dhe kthimin e posedimit të pronës, Banesës, në sipërfaqe prej 71.12m2, e cila gjendet në, (tutje: prona e kërkuar).
2. Në formularin e kërkesës pala kërkuese (tutje, pala ankuese) deklaroi se, ajo e ka shfrytëzuar pronën e kërkuar në vitin 1998, gjer sa ishte dëbuar me forcë nga pushteti i atëhershëm, andaj vlerëson se humbja e posedimit të banesës lëndore është si pasojë e rrethanave që ndërlidhen në Kosovë të viteve 1998/99. Po ashtu thekson se pas lufte nuk ka pas qasje në banesën e saj sepse ishte e uzurpuar nga Y. K..
3. Në mbështetje të kërkesës, pala ankuese në AKP *inter alia*, ka paraqitur dokumentet si në vijim;
 - Kontratën për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të banesës lëndore, me nr. 360-33, të dt. 18.06.1998, sipas së cilës fondi i solidaritetit “Solidarnost”, për objekte strehimi, si

transferues i të drejtës së shfrytëzimit të kësaj banese në Ndërmarrjen Komunale Publike, “Higjiena”

- Vendimin nr. 01-934/1, të datës 30.06.1998, lëshuar nga Ndërmarrja Publike Komnlae “Higjiena”, në Prizren mbi ndarjen e banesës lëndore në shfrytëzim, bartëses së të drejtës banesore L. B., bazuar në kontratën për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit, nr. ..., ngafondi i solidaritetit.
 - Kontratën me nr. ..., të dt. 30.06.1998, për ndarjen e të drejtës së shfrytëzimit nga Ndërmarrja Publike Komunale Higjiena, palës ankuese L. B..
 - Aktgjykimin, C.nr.423/05, të dt. 06.06.2011, sipas të cilit Gjykata komunale Prizren, e aprovon kërkesëpadinë e palës ankuese L. B. kundër palës përgjegjëse E. Z., asaj ia kthen posedimin dhe të drejtën e shfrytëzimit në banesën lëndore, ndërsa pala përgjegjëse obligohet që ta liroj banesën në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
4. Me datë 25 Janar 2008, AKP-ja kishte bërë njoftimin dhe notifikimin e pronës lëndore, e njëjta gjatë kohës së vizitës ishte gjetur se ishte e uzurpuar nga E.Z.. I njëjti kishte deklaruar se pasi e ka zgjidhur çështjen e kësaj banese me Y. K., (banues i më parshëm) dhe pasi i është lejuar verbalisht nga Komuna ..., është vendosur në këtë banesë në vitin 2006.
5. Sekretaria e AKP-së, gjatë verifikimit *ex officio*, në Gjykatën e Qarkut në Prizren, ishte gjetur dhe verifikuar pozitivisht aktgjykimi i kësaj gjykate, Ac.nr. 406/2011, i dt. 05.12.2012, (i ofruar edhe nga pala ankuese L. B.),sipas së cilit ishte refuzuar ankesa e palës përgjegjëse E. Z., ndërsa ishte konfirmuar aktgjykimi i shkallës së parë, C. Nr. 423/05, i dt. 06.06.2011, me të cilin ishte aprovuar kërkesë padia e ankueses L. B.a dhe i ishte njohur e drejta banesore në banesën lëndore. Po ashtu dokumentet e tjera relevante të paraqitura nga pala ankuese në APK të cekura si në parag. 3 të këtij aktgjykimi nga sekretaria ishin verifikuar pozitivisht.
6. Me datë 11 qershor 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës, (në tekstin e mëtejme: KKPK), përmes Vendimit të tij KPCC/D/R/207/2013, (në tekstin e më tejme: Vendimi i KKPK-së), e hedhë poshtë kërkesën e L. B., si çështje e gjykuar, (*res judicata*). Në arsyetimin e vendimit grupor (paragrafi 24), KKPK thekson se, e njëjta kërkesë e saj për të njëjtën banesë nga provat e dorëzuara nga ajo, dhe të siguruara *ex officio* nga sekretaria, rezulton se, çështja e njëjtë ishte vendosur me vendim të formës së prerë të organit administrativ apo gjyqësor si në rastin konkret, andaj bazuar

në dispozitat e nenit 11.4, të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, KKPK do ti hedhë kërkesat të cilat janë vendosur më parë nga një organ kompetent apo gjyqësor.

7. Vendimi i KKPK-së, i është dorëzuar palës ankuese, me datë 29 Tetor 2013.
8. Kjo lëndë në AKP është mbyllur si jo e kontestuar, me datë 20 mars 2015.
9. Me datë 07 Qershor 2019, pala ankuese ka ushtruar ankesë kundër vendimit të KKPK, sa i përket kërkesës së saj KPA11753.

Pretendimet e palës ankuese;

10. Pala ankuese në ankesë (të cilën e titullon kërkesë), thekson se nuk është e kënaqur me vendimin të cilin e ka marrë me numër të lëndës 11753, andaj dëshiron që lënda ti procedohet tutje në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Arsyetimi ligjor;

Pranueshmëria e ankesës,

11. Ankesa është e pa pranueshme, sepse është paraqitur pas afatit të paraparë ligjor.
12. Neni 12.1, i Rregullores 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, Mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, (në tekstin e mëtejme “Ligji nr. 03/L-079”), përcakton si në vijim: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqes ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”*.
13. Nga shkresat e lëndës provohet se, pala ankuese e ka pranuar Vendimin e KKPK-së, me datë, 29 tetor 2013, kurse ankesë kundër këtij vendimi ka paraqitur me datë 07 qershor 2019. Pas llogaritjes së afatit nga dita e paraqitjes së ankesës, vërtetohet se ankesa është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar me ligj 30 ditë, nga dita e pranimit të Vendimit të KKPK-së.

14. Nga faktet e vërtetuara, gjykata gjen se dorëzimi i vendimit të ankimuar është bërë në përputhje me nenin 110.1, të Ligjit nr. 03/L-006, për Procedurën Kontestimore, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 38/2008). Pala ankuese nuk ka theksuar ndonjë arsye dhe nuk ka paraqitur ndonjë provë me ankesë, për paraqitjen me vonesë të ankesës. Gjithashtu gjykata në shkresat e lëndës nuk ka gjetur prova të justifikueshme që e arsyetojnë vonesën e ushtrimit të ankesës nga pala ankuese.
15. Në bazë të asaj që u tha më lart, rrjedhimisht Gjykata Supreme nuk ka mundur të shqyrtoj dhe të vendos meritorisht në këtë çështje, prandaj në përputhje me nenin 13.3.(b), të Rregullores 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, dhe nenin 195, paragrafin 1, (a), të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore ;

16. Sipas nenit 13.6 të Rregullores, nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë, nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

GSK-KPA-A-004-2019, me datë 24 Dhjetor 2020

Bashkp. Profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani